



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 25/23

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga, Vedat Poterqoi Kryetarë, Agon Ramadani dhe Kimete Gashi anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik, (OE) "El-Bau" sh.p.k- me seli në Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Intervenime infrastrukturore në territorin e Komunës së Prishtinës Llot-2" me nr. të prokurimit: 616-22-10564-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna e Prishtinës, më datën 29.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

- Hedhet si e palejuar**, ankesa e Operatorit Ekonomik "El-Bau" sh.p.k me seli në Gjilan, nr.25/2023, përkitazi, me aktivitetin e prokurimit me titull: "Intervenime infrastrukturore në territorin e Komunës së Prishtinës Llot-2" me nr. të prokurimit: 616-22-10564-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues, Komuna e Prishtinës, si palë pa interes juridik material, konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së.
- Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 10.01.2023, ka pranuar ankesë nga OE “El-Bau” sh.p.k, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Intervenime infrastrukturore në territorin e Komunës së Prishtinës Llot-2” me nr. të prokurimit: 616-22-10564-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues, Komuna e Prishtinës, ankesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër të protokollit 25/2023.

Me datë 27.12.2022, Operatori Ekonomik “El-Bau” sh.p.k ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Kuvendi Komunal Prishtinës, me datë 28.12.2022 AK Komuna e Prishtinës e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim dhe ka vërtetuar B58 Njoftimin mbi Vendimin e AK të datës 22.12.2022. Me datën 10.01.2023 Operatori Ekonomik “El-Bau” sh.p.k ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 25/2023, kundër B58 Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër, ku është rekomanduar për Kontratë Grupi i Operatorëve Ekonomik “Alfa I”, Urban O.P, Bujar Shabani B.I

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur - Punë, vlerë e madhe, kriteri i dhënies së kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmimi më të ulët të poentuar vlera e parashikuar e kontratës për të gjitha LOT- et është 2,500,000.00 €. Ndërsa për LOT – 2 vlera e parashikuar është në vlerë prej: 400,000.00 €.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 20 janar 2023 me raportin e ekspertizës. Me datë 23 janar 2023 AK Kuvendi Komunal Prishtinë ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa me datë 23 janar 2023 OE “N.T.P. “El-Bau” sh.p.k, ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 20.01.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues “El-Bau” sh.p.k të refuzohet si e pa bazuar,
- të mbetet në fuqi vendimi i AK i datës 22.12.2022, (*vendim për të dhënie të kontratës*).

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “El-Bau” sh.p.k me seli në Gjilan

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimit ankimore, eksperti shqyrtues vlerëson se AK me rastin e zbatimit të këtij aktiviteti të prokurimit gjatë fazave të tenderit duke filluar që nga njoftimi e deri tek publikimi i rezultateve për vlerësimin e këtij

aktiviteti ka vepruar në përputhje me dispozitat e LPP-së, dhe si rezultat i kësaj AK nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPP –së të theksuara me përjashtim të pretendimeve ankimore që në parim kanë të bëjnë me mos respektimin e nenin 61 të LPP-së dhe neni 41 RRPP - së pasi që çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar konsiderohen jashtëzakonisht/jo normalisht të ulëta dhe të larta.

Pra çmimi i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë bazuar në çmimet ofertuese konsiderohet i ulët në disa pozicione por kjo mbetet në përgjegjësi të Autoritetit Kontraktues, sipas nenit 61 të LPP-së. Është përgjegjësi dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit -ZPP.

Eksperti shqyrtues ka vlerësuar ofertën e OE ankues dhe ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe si oferta kanë diferencë mes tyre dhe ofertuesve tjerë por duhet pasur parasysh që kriter për vlerësimi ka qenë çmimi më i ulët i poentuar dhe AK në përputhje me kriterin e përcaktuar në dosjen e tenderit dhe në paramasa dhe llogaria ka vepruar që do të thotë se i ka peshuar çmimet sipas përqindjes së përcaktuar dhe çmimi i ofertës është peshuar (poentuar) në raport me përqindjen e përcaktuar nga autoriteti kontraktues.

Esenca e poentimit është që operatorëve ekonomik të ju pamundësohet që të ofrojnë çmime abnormalisht të ulëta apo larta në pozicione të caktuara dhe këtu qëndron rëndësia e poentimit apo peshimit të çmimeve. Ne kemi bërë një analizë financiare sikurse oferte të OE ankues njëkohësisht edhe ofertës së OE të rekomanduar për kontratë e cila parimisht por edhe praktikisht duken që çmimet janë të nënvlerësuar si dhe të mbi vlerësuar në disa pozicione të ofertave.

Autoriteti kontraktues përmes Letrës Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit të dërgua me datën: 12.12.2022 përmes platformës elektronike ka kërkuar nga OE një DEKLARATË me shkrim të vulosur dhe të nënshkruar se pajtoheni që të bëni sigurimin e ekzekutimit në vlerë prej 30% të vlerës së kontratës. Kurse OE me datën: 12.12.2022 është përgjigjur përmes deklaratës me shkrim se pranon të bëjë sigurimin e ekzekutimit sipas kërkesës së AK.

Kërkesa e sigurimit të ekzekutimit do të aplikohet për të gjithë tenderuesit dhe kushtet do të parashtrohen në dosje të tenderit dhe në njoftim për kontratë e që AK ka zbatuar këtë nen.

29.4 Shuma e sigurimit të ekzekutimit do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës, ndërsa të kontrata me çmim për njësi apo me poentim kërkohet 10% e vlerës së parashikuar. Kur përcaktohet përqindja e sigurimit të ekzekutimit, në rast të kontratave me vlerë të mesme ose të madhe, AK do të siguroj që përqindja mjafton për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shpëputet kontrata. Autoriteti kontraktues, pasi që të jetë përputhur me nenin 61 të LPP-se, ka mjaft arsye për të besuar se Operatori ekonomik e ka dorëzuar një tender të pa-zbatueshëm (jo-normalisht të ulët), gëzon të drejtën që përqindjen e kërkuar të sigurimit të ekzekutimit ta rris për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shpëputet kontrata.

Eksperti shqyrtues se në rastin konkret edhe çmimi i ulët dhe i lartë i bart rreziqet e veta, andaj mbete përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues çështja e kontraktimit të çmimeve pasi qe procesi i vlerësimit është bërë në përputhje të kërkesa e Autoritetit Kontraktues të paraqitura në dosjen e tenderit dhe me dispozita të LPP –së.

Duke u bazuar në vlerësimet dhe konstatimet e lartcekura Eksperti Shqyrtues i rekomandon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar dhe njëkohësisht propozon që vendimi i AK –së të mbetet në fuqi pasi që rekomandimi për kontratë është bë në bazë të kriterit të përcaktuar për vlerësim dhe është në diskrecion të vendos për çmimet e ulëta apo të larta.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të merret si e pabazuar dhe Vendimi mbi autoritetin kontraktues të mbetet në fuqi.

-Konstatimet e Panelit Shqyrtues-

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me dt. 21.03.2023.

Duke i analizuar pretendimet e ankuesit, përmbajtjen e tyre dhe raportin e ekspertit shqyrtues Paneli Shqyrtues konsideron se:

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyre të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër dhe rrjedhën e procedurës. Sikurse mund të kuptohet edhe nga përmbajtja e ankesës, apriori pretendimet ankimore nuk konsistojnë në faktin nëse është atakuar apo jo interesi ekonomik i Ankuesit. Prandaj parashtruesi i ankesës nuk mund ta ketë statusin e palës me interes në kuptim të paragrafit 1.26, të nenit 4 (Përkufizimet), të LPP, sipas të cilit palë e interesuar është personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit. Paneli shqyrtues detyrohet ta marrë në konsideratë faktin parimore se, tenderi i ofruar nga OE ankues sipas shumës së ofruar është i radhitur i 5 (pesti) me radhë në procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, i njoftuar zyrtarisht nga AK me anë të letrës standarde për tenderuesin e pasuksesshëm dhe me anë të pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e tij e atakon vetëm të rekomanduarin e nuk e argumenton pohimin se operatorët tjerë të radhitur para tij nuk janë të përgjegjshëm, ndërsa OE të cilët janë të radhitur para tij, janë më të lirë për nga çmimi dhe janë të përgjegjshëm.

Në kontekstin shpjegimeve si më sipër, Paneli i vuri në zbatim po ashtu nenin 103, të LPP, sipas të cilit, “Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term (“palë e interesuar”) në nenin 4 të këtij ligji”. Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar në këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP.

Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli konsideron se parashtruesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar dhe se nuk ka nevojë të lëshohet në vlerësimin meritator të pohimeve specifike të kësaj Ankese, sepse të njëjtat janë jo lëndore në kuptim të neni 111, të LPP. Ndërsa, autoriteti kontraktues mbanë përgjegjësi të plotë sa i përket respektimit të dispozitave ligjore për prokurimit publik.

- Përfundim -

Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Vendimi sikurse në pikën 2, të dispozitivit është marrë në kuptim se njoftimi për OE i publikuar në ueb faqen e OSHP, sa i përket konfiskimit të tarifës së ankesës në këto raste të ngjashme të trajtimit të “palës pa interes” është bërë pasi që është parashtruar ankesa në OSHP.

Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Vedat POTERQOI



A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Vedat Poterqoi', is written over a horizontal line. The signature is fluid and cursive.



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna e Prishtinës

1x1 OE "El-Bau" sh.p.k- me seli në Gjilan

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.